

NË EMER TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi, kryetar, Fillim Skoro, gjyqtar referues, e Have Haliti, anëtare, me bashkëpunëtoren profesionale Leonita Lajçi, si procesmbajtëse, në lëndën penale të akuzuarve N.D. dhe S.D., nga fshati ..., rrethi i Kukësit, Republika e Shqipërisë, për shkak të veprës penale blerja, posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope e analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK, duke vendosur përkitazi me ankesat e mbrojtësve të akuzuarve, av.D.O. dhe av.F.A., të ushtruara kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.187/2017, të dt.02.11.2017, në seancën publike të kolegjit të mbajtur me dt.21.12.2017, morri këtë:

AKTGJYKIM

I. Me aprovimin e ankesave të mbrojtësve të akuzuarve N.D. e S.D., av.D.O. dhe av.F.A., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore- DKR në Prishtinë, PKR.nr.187/2017, të dt.02.11.2017, sa i përket vendimit mbi dënimin ashtu që Gjykata e Apelit, të akuzuarve për veprën penale blerja, posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope e analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK, e më afër të përshkruar si në dispozitivin e aktgjyqimit, secilit të akuzuar veç e veç, iu shqipton dënimin me gjobë në shumë prej nga 2.000(dymijë)Euro, dhe secilit veç e veç, iu shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej nga 1(një)vit e 6(gjashtë)muaj, e në të cilin dënim me burgim secilit veç e veç do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.24.03.2017 e tutje. Dënimin e shqiptuar me gjobë të akuzuarit detyrohen ta paguajnë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse të njëjtin nuk e paguajnë në afatin e caktuar, dënimi i shqiptuar me gjobë do të zëvendësohet me dënim burgimi, ashtu që për çdo 20 (njëzet)Euro, secilit prej të akuzuarve do tu llogaritet nga një ditë burg.

II. Në pjesët tjera aktgjykimi mbetet i pa prekur.

Arsyetim

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.187/2017, të dt.02.11.2017, të akuzuarit N.D. e S.D., janë shpallur fajtor për veprën penale blerja, posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope e analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK dhe janë gjykuar secili veç e veç me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2(dy)vite e në të cilin dënim të dyve u janë llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.24.03.2017 e tutje, si dhe me dënim gjobë në shumë prej nga 3.600(tremijegjashtëqind)Euro, të cilin dënim të akuzuarit janë të obliguar ta paguajnë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit, e nëse të njëjtin nuk e paguajnë në afatin e caktuar, dënimi i shqiptuar me gjobë do të zëvendësohet me dënim burgimi, ashtu që për çdo 20 (njëzet)Euro, secilit prej të akuzuarve do tu llogaritet nga një ditë burg.

Nga të akuzuarit është konfiskuar vetura "Ford", me ngjyrë të kuqe, pronë e të akuzuarit N.D., me targa AA-669-FY dhe narkotikët e llojit marihuan në peshë të përgjithshme prej 2.149,5gr.

Të akuzuarit N.D. e S.D., janë obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë secili veç e veç shumën prej nga 100(njëqind)Euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij, aktgjykimi me kohë kanë ushtruar ankesa:

-Mbrojtësit e të akuzuarve N.D., e S.D., av.D.O. dhe av.F.A., të dytë për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, që të dytë në ankesat e tyre kanë propozuar që të aprovohen ankesat si të bazuara të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe të mbrojturve të tyre t'iu shqiptohet dënim më i lehtë, duke marrë parasysh rregullat dhe rrethanat posaçërisht lehtësuese.

-Prokuroria e Apelit, me shkresën e saj PPA/I.nr.530/2017, të dt.13.12.2017, duke u sqaruar përkitazi me ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve N.D. e S.D., av.D.O. e av.F.A., ka propozuar që ankesat e mbrojtësve të akuzuarit të refuzohen si të pabazuara dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, caktoi seancën e kolegjit, konformë nenit 390 par.1 të KPP, në të cilën morën pjesë të akuzuarit N.D. e S.D., dhe mbrojtësit e tyre av.D.O. e av.F.A., ndërsa ka munguar Prokurori i Apelit-DKR në Prishtinë, i cili me shkresën e tij është deklaruar që ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve të refuzohen si të pabazuara dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar sipas pretendimeve ankimore të mbrojtësve të të akuzuarve N.D. e S.D., av.D.O. e av.F.A., edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPP, e duke marrë parasysh edhe sqarimin e Prokurorisë së Apelit-DKR në Prishtinë, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesat e mbrojtësve të akuzuarve N.D. e S.D., janë të bazuara.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

Mbrojtësit e të akuzuarve N.D. e S.D., në ankesat e tyre e të cilat nga përmbajtja janë tërësisht identike, pretendojnë se gjykata e shkallës së parë, nuk ka marrë parasysh moshën e të akuzuarve N.D. e S.D., pranimin e fajit nga ana e të akuzuarve N.D. e S.D., keqardhjen e tyre, sjelljen e të akuzuarve, pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve, e sidomos duke marrë parasysh gjendjen e vështirë ekonomike dhe nevojat për shërimin e bashkëshortëve të tyre të cilat vuajnë nga sëmundjet e rëndë mentale, e duke marrë parasysh gjendjen ekonomike të akuzuarve, e cila është mjaft e rëndë dhe të akuzuarit N.D. e S.D. në asnjë mënyrë nuk mund të përmbushin detyrimin për dënimin e shqiptuar me gjobë.

Gjykata e Apelit, në pajtim me nenin 394 par.1 të KPP, duke e shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesat e mbrojtësve të akuzuarve, e sipas detyrës zyrtare në kuptim të ekzistimit të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 dhe shkeljes së ligjit penal, nga neni 385 par.1 të KPP, Gjykata e Apelit, gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është përfshirë në shkeljet e cekura më lartë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Gjykata e Apelit, duke e vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, përkitazi me vendimin mbi dënimin, e sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesat e mbrojtësve të akuzuarve, gjen se pretendimet ankimore janë të bazuara, për faktin se dënimet e shqiptuara me gjobë secilit veç e veç në shumë prej 3.600(tremijegjashtëqind)Euro, dhe dënimet me burgim secilit veç e veç të shqiptuara prej nga 2(dy)vite burgim, nuk janë në përpjesëtim me peshën e veprës penale si pasojë e mos vlerësimit të drejtë të rrethanave lehtësuese të cilat shkojnë në dobi të akuzuarve, e të cilat në një masë janë cekur në dy ankesat e mbrojtësve të akuzuarve.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, nuk ka vlerësuar rrethanat lehtësuese lidhur me vendimin mbi dënimin e shqiptuar me gjobë dhe dënimin e shqiptuar me burgim, se të akuzuarit N.D. e S.D., pas kryerjes së veprës penale kanë pranuar fajësinë, në vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor në procesverbalin e dt.02.11.2017, para kryetarit të trupit gjykues, se janë penduar për veprën e kryer penale dhe kanë shprehur keqardhje të thellë, duke marrë parasysh se i akuzuari N.D., është edhe familjar, që të dy janë të gjendjes së varfër ekonomike, se nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale, gjë që tregon se sjelljet e tyre kanë qenë në harmoni me normat pozitive të shoqërisë, e duke marrë parasysh qëndrimin korrekt dhe sjelljet e tyre, gjykata ndryshoi aktgjykimin për të dy të akuzuarit N.D.t e S.D., ashtu që secilit të akuzuar ia shqiptoi të dënimin me gjobë në shumë prej nga 2.000(dymijë)Euro, dhe dënimin me burg secilit në kohëzgjatje prej nga 1(një)vjet e 6(gjashtë)muaj, e në të cilat dënime me burgim, të dy akuzuarve N.D.t e S.D. iu është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej dt.24.03.2017, e duke marrë parasysh se nga i akuzuari N.D. është konfiskuar vetura e markës "Ford", dënimi kumulative të shqiptuara me gjobë dhe burgim, janë në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të dy të akuzuarve, me bindje se dënimet e shqiptuar secilit veç e veç të akuzuarve N.D. e S.D., do të arrihet qëllimi i dënimin të paraparë në nenin 41 të KPRK, si preventiva individuale që të parandalojë të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe preventiva e përgjithshme që ti parandalojë edhe personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Meqë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ndryshuar u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në konformë të nenit 403 par.1 të KPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.565/2017, me dt.21.12.2017

Procesmbajtëse,

Leonita Lajçi

Anëtarët e kolegjit,

Fillim Skoro

Have Haliti

Kryetari i kolegjit,

Xhevdet Abazi